



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 58, PARAQITUR NË KQZ
NË DATËN 08.07.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 08.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Konservatore Albania

OBJEKT: Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve për Kryetar në Bashkinë Lezhë.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "a" dhe neni 126, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Partia Konservatore Albania, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr.58 regj, datë 08.07.2019.

Në mbledhjen e datës 09.07.2019, ora 10:00 pas relativitetit të z. Bledar Skënderi, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 58 i plotësonte



elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 58, datë 08.07.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Konservatore Albania.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 11.07.2019, në orën 17:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

